



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“DIZENJIM DHE DEKORIM I AMBIENTEVE TË BRENDSHME”

Niveli Vnë KSHK¹, referuar niveli V të KEK²

B1-V-25

Tiranë, 2025

¹Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

²Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi:	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	4
Ofruesit	4
Data e validimit.....	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT.....	5
Kompetenca të përgjithshme (qëndrimet).....	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL	5
NjN-02-V-0206-25 Planifikimi dhe organizimi i punës për dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
NjN-02-V-0207-25 Vizatimi (teknik, i lirë dhe digjital etj.)	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	9
NjN-02-V-0208-25 Histori arti pamor dhe arkitekturë	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	11
NjN-02-V-0209-25 Dokumentacioni teknik në dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme.....	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12
NjN-02-V-0210-25 Baza e ndërtimit.....	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	14
NjN-02-V-0211-25 Bazat e projektimi	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri	14
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	15
Kriteret e vlerësimit	15
NjN-02-V-0212-25 Mobilimi i hapësirës	16
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	16
Kriteret e vlerësimit	17
NjN-02-V-0213-25 Projektim, Dizenjim, Dekorim	18
Rezultatet e të nxënit në njohuri	18
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	19
Kriteret e vlerësimit	19
NjN-02-V-0214-25 Hartimi i projekt – zbatimit	20
Rezultatet e të nxënit në njohuri	20
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	21
Kriteret e vlerësimit	21
NjN-02-V-0215-25 Realizimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të projektit.....	22
Rezultatet e të nxënit në njohuri	22
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	23
Kriteret e vlerësimit	23
NjN-23-V-0111-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere.....	24
Rezultatet e të nxënit në njohuri	24
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	25
Kriteret e vlerësimit	25
NjN-22-V-0130-24 Komunikimi dhe etika profesionale.....	26
Rezultatet e të nxënit në njohuri	26
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	26
Kriteret e vlerësimit	26
NjN-02-V-0216-25 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme	27
Rezultatet e të nxënit në njohuri	27
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	27
Kriteret e vlerësimit	28
Njësitë e të nxënit dhe peshat përkatëse:	28
Modalitetet e vlerësimit	29
Informacion shtesë	29
SHËNIM	29

Emërtimi i kualifikimit	Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme			Kodi
Kohëzgjatja	2200-3000 orë nacionale	Niveli	Niveli V në KSHK, referuar nivelit V në KEK	B1-V-25
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V në KSHK, referuar nivelit V në KEK është zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në fushën e dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme, si dhe krijimi dhe menaxhimi i një biznesi privat, si person fizik ose juridik.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V në KSHK, referuar nivelit V në KEK kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: – kanë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK (arsimi i përgjithshëm, arte figurative, shkollën e mesme profesionale në kualifikimin profesional i ndërtim); – janë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryerjen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional; – pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Me përfundimin me sukses të kualifikimit profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V në KSHK, referuar nivelit V në KEK, individi pajiset me Certifikatën e aftësisimit profesional dhe suplementin përkatës, që njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës si specialist në fushën e dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme në studio të dizenjimit të brendshëm (interior design), mobileri, studio arkitekture (projektim dhe zbatim arkitekture), kompani ndërtimi (në fushën e zbatimit të projekteve të ndërtimit), kompani në fushën e organizimit të eventeve, në panaire dhe ekspozita, në institucione, zyra private ose publike që merren me dizenjim, arredim dhe dekorim të ambienteve të brendshme, në media televizive (skenografi), zyra të ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme (real estate), si dhe të krijojë një biznes privat, si person fizik ose juridik për dizenjim dhe dekorim të ambienteve të brendshme.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Qershor 2025			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme				

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme” niveli V në KSHK, referuar nivelit V të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehitë profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

Kompetenca të përgjithshme (qëndrimet)

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tij, si dhe për të argumentuar opinione për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore, profesionale dhe komunitet;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
15. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-02-V-0206-25 Planifikimi dhe organizimi i punës për dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë kuadrin ligjor dhe rregullator në fushën e arkitekturës;
2. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të burimeve të nevojshme për realizimin e projektit;
3. Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për proceset e punës;
4. Të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit të objektit dhe të terrenit ku ai ndodhet;
5. Të rendisë strukturat organizative të kompanisë sipas hierarkisë;
6. Të interpretojë zbërthimin e projekt-zbatimit, simbolet, shenjat dalluese në skica, detaje, preventivit etj.;
7. Të shpjegojë përdorimet e programeve kompjuterike (Autocad, Office, Adobe etj.) në fushën e projektimit për hartimin e projektit;
8. Të shpjegojë planin e organizimit të punimeve dhe mënyrat e zbatimit të tij;
9. Të vlerësojë rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit me eprorët dhe me grupe të tjera për mbarëvajtjen e punës gjatë të gjitha proceseve;
10. Të argumentojë ndarjen e detyrave për çdo specialist sipas proceseve të punës;
11. Të argumentojë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
12. Të shpjegojë rëndësinë e sistemit dhe pastrimin e vendit të punës para, pas dhe gjatë punës;
13. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e raportimit për ecurinë e punës;
14. Të shpjegojë metodat e kërkimit dhe përpunimit të informacionit;
15. Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit të bazës së të dhënave të kontakteve të furnitorëve;
16. Të argumentojë vendosjen e prioriteteve, të radhës së punës, si dhe hartimin e grafikut të veprimtarive.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të planifikojë veprimtarinë ditore, javore, mujore dhe burimet e nevojshme për realizimin e projektit;
2. Të hartojë planin organizativ të menaxhimit të projektit, duke llogaritur rrjedhën dhe kohëzgjatjen e veprimtarive;
3. Të menaxhojë burimet materiale, njerëzore dhe financiare për zhvillimin e biznesit;
4. Të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet në funksion të natyrës së proceseve të punës;
5. Të demonstrojë përdorimin e programeve kompjuterike si AutoCAD dhe Office në hartimin dhe menaxhimin e projekteve arkitektonike;
6. Të bashkëpunojë me eprorë, kolegë dhe grupeve për garantimin e mbarëvajtjes së punës;
7. Të organizojë vendin e punës duke zbatuar parime ergonomike dhe standarde teknike;
8. Të përdorë metoda efektive për kërkimin dhe përpunimin e informacionit;
9. Të përditësojë bazën e të dhënave të proceseve, mjeteve dhe bashkëpunëtorëve në projekt.

Kriteret e vlerësimit

- Planifikon veprimtarinë ditore sipas kërkesave të marra;
- Kryen planifikimin e veprimtarive mujore sipas objektivit të organizatës;
- Planifikon bazën materiale të nevojshme sipas specifikimeve teknike të projektit;

- Planifikon burimet njerëzore të nevojshme sipas proceseve të punës;
- Planifikon pajisjet dhe mjetet e punës sipas proceseve të punës;
- Planifikon proceset e punës sipas radhës logjike të punimeve ndërtimore;
- Përzgjedh grupet e punës sipas grafikut të punimeve;
- Përcakton kohëzgjatjen e secilit aktivitet në përputhje me burimet dhe kapacitetet;
- Kryen ndarjen e detyrave dhe grupeve të punës sipas grafikut të punimeve dhe proceseve të punës;
- Zbaton teknika të vlerësimit dhe motivimit të stafit;
- Koordinon bashkëpunimin me eprorët dhe specialistët e tjerë, sipas rregullores së brendshme;
- Siguron burimet e nevojshme financiare sipas planifikimit të bërë;
- Përzgjedh mjetet dhe pajisjet, sipas funksionit dhe proceseve të punës;
- Kontrollon gatishmërinë për punë të makinerive, pajisjeve dhe mjeteve të punës sipas proceseve të punës dhe udhëzimeve përkatëse;
- Organizon vendin e punës sipas standardeve dhe kushteve teknike të zbatimit;
- Kontrollon funksionalitetin e programeve kompjuterike si AutoCAD dhe Office në hartimin dhe menaxhimin e projekteve arkitektonike;
- Përdor programe kompjuterike si p.sh. AutoCAD për draftimin e vizatimeve sipas nevojave të projekteve arkitektonike;
- Përdor programe kompjuterike si p.sh. Office për menaxhimin e informacionit sipas nevojave të projekteve arkitektonike;
- Koordinon aktivitetet me kolegët dhe grupet e punës për të shmangur vonesat apo ndërlikimet;
- Merr pjesë në mbledhje pune për të ndarë informacionin dhe për të kontribuar me zgjidhje konkrete;
- Respekton përgjegjësitë dhe rolet e secilit anëtar të ekipit për të siguruar efikasitet në proces;
- Sistemon mjetet dhe pajisjet sipas rregullave të sigurisë dhe aksesit të shpejtë;
- Aplikon standardet ergonomike për të shmangur lodhjen fizike dhe dëmtimet në punë;
- Siguron ndriçimin, ventilimin dhe qasje të lehtë në hapësirat e punës sipas kërkesave teknike;
- Kërkon dhe mbledh informacionin e nevojshëm nga burime të besueshme për të mbështetur vendimmarrjen dhe proceset e punës;
- Analizon informacionin në mënyrë të detajuar për të siguruar që të dhënat të jenë të sakta dhe të përdorshme për zhvillimin e projekteve;
- Aplikon teknika dhe mjete të avancuara për përpunimin e informacionit dhe prezantimin e rezultateve në mënyrë efikase;
- Përdor burime dhe teknologji të avancuara për të rritur shpejtësinë dhe saktësinë e kërkimit të informacionit;
- Menaxhon rregullisht bazën e të dhënave që përmban informacion për proceset, mjetet dhe partnerët e përfshirë në projekt;
- Siguron që të dhënat për çdo fazë të projektit të jenë të organizuara dhe të aksesueshme për

të gjithë anëtarët e ekipit;

- Rishikon dhe përditëson informacionin lidhur me furnizuesit dhe bashkëpunëtorët e mundshëm për t'u siguruar që janë të përfshirë në proceset e nevojshme të projektit.

NjN-02-V-0207-25 Vizatimi (teknik, i lirë, digjital etj.)

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë elementet bazë të një vizatimi teknik (titulli, përmasat, shkallët, linjat etj.);
2. Të shpjegojë simbolet standarde të përdorura në plane dhe skica;
3. Të interpretojë plane teknike për të ndërtuar një objekt të caktuar;
4. Të listojë komponentët në një vizatim të detajuar teknik;
5. Të rendisë hapat për realizimin e një vizatimi teknik që nga ideja deri te finalizimi;
6. Të japë shembuj të aplikimit vizatimet teknike;
7. Të shpjegojë rolin e saktësisë në realizimin e një vizatimi teknik;
8. Të identifikojë mjetet dhe materialet e përdorura në vizatimin teknik;
9. Të klasifikojë llojet e vizatimeve sipas qëllimit dhe përdorimit të tyre (arkitektonik, konstruktiv, mekanik, elektrik etj.);
10. Të interpretojë specifikimet teknike për të realizuar vizatime sipas udhëzimeve;
11. Të përshkruajë parimet dhe bazat e gjeometrisë deskriptive;
12. Të identifikojë teknikat e ndryshme të vizatimit të lirë (me laps, karbon, bojë etj.);
13. Të klasifikojë llojet e vizatimeve sipas qëllimit (artistike, konceptuale);
14. Të krahasojë vizatimin e lirë me vizatimin teknik në aspektin e qasjes dhe qëllimit;
15. Të diskutojë përdorimin e elementëve të kompozicionit në artin vizual;
16. Të vlerësojë veprat e vizatimit të lirë përmes kritikës artistike;
17. Të gjykojë përdorimin e ngjyrës, vijës dhe teksturës në një punim vizatimor;
18. Të përshkruajë stilin dhe teknikat e artistëve të ndryshëm;
19. Të listojë softuerët dhe aplikacionet më të përdorura për vizatim digjital dhe vizualizim;
20. Të rendisë hapat për krijimin e një projekti vizatimor digjital;
21. Të shpjegojë elementët kryesorë të vizatimit digjital;
22. Të shpjegojë teknikat e komunikimit vizual (kolazh, fotografi, vizualizim, skica digjitale....);
23. Të japë shembuj të projekteve të realizuara në platforma digjitale;
24. Të klasifikojë vizatime digjitale sipas formateve dhe përdorimit;
25. Të shpjegojë funksione të avancuara në ndërtimin e vizatimeve digjitale imazheve 3D;
26. Të listojë metodat e riprodhimit të skicave në vizatime digjitale;
27. Të rendisë programet kompjuterike që përdoren në vizatime teknike, modelime të mobilieve dhe detajeve të tyre (si p.sh. Autocad, Rhino, SketchUp etj.);
28. Të rendisë programet kompjuterike që përdoren për vizualizime fotorealistike (si p.sh. Blender, 3D Max, Lumion, V-Ray);
29. Të listojë programet kompjuterike që përdoren për vizatime parametrike në mobilet me forma modulare (Grasshopper).

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të modelojë projektin arkitektonik 3 dimensional fizik (maket) dhe digjital;

2. Të përdorë mjetet dhe materialet e duhura për lloje të ndryshme vizatimesh;
3. Të riprodhojë vizatime teknike duke përdorur elementet dhe hapat përbërës të tyre;
4. Të vizatojë planimetri, pamje, prerje etj. sipas projektit përkatës;
5. Të vizatojë detaje të ndryshme duke vendosur përmasat dhe duke përdorur shkallët e vizatimit;
6. Të riprodhojë vizatime duke përdorur elemente dhe teknika të vizatimit të lirë;
7. Të përdorë programe kompjuterike për vizatim dhe modelim të projektit arkitektonik.

Kriteret e vlerësimit

- Modelon projektin arkitektonik 3 dimensional digjital sipas programeve përkatëse;
- Modelon projektin arkitektonik 3 dimensional fizik sipas metodologjive dhe materialeve përkatëse;
- Përdor mjetet dhe materialet në vizatimin teknik sipas funksionalitetit të tyre;
- Përdor teknika të ndryshme (me laps, me karbon, me bojë etj.) sipas llojit të vizatimit;
- Riprodhon vizatime bazë duke përdorur instrumentet përkatëse sipas rregullave gjeometrike të vizatimit teknik;
- Riprodhon elementë vizualë duke përdorur teknika vektoriale dhe imazhe (*raster*) sipas programeve përkatëse;
- Specifikon elementët bazë të një vizatimi teknik (titulli, përmasat, shkallët, linjat, etj.) sipas standardeve të përcaktuara;
- Përdor simbolet standarde të përdorura në plane dhe skica sipas udhëzuesve teknik;
- Zbaton hapat për realizimin e një vizatimi teknik nga ideja deri te finalizimi sipas rrjedhës së punës;
- Përzgjedh forma dhe stile të ndryshme të vizatimit teknik sipas qasjeve metodologjike të ndryshme;
- Vizaton modele të thjeshta me anë të pamjeve dhe aksonometrisë sipas projektit të dhënë;
- Vizaton prerje të detajuara sipas shkallës së vizatimit;
- Dallon shenja konvencionale të instalimeve (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje- ftohje-ventilim, gaz etj.) të përdorura në një objekt të thjeshtë;
- Përpunon detaje të fletëve të vizatimeve teknike sipas kërkesës së projektuesit;
- Zbaton specifikimet teknike për realizimin e detajeve në përputhje me kërkesat e projektit;
- Riprodhon vizatimet sipas qëllimit (artistike, konceptuale) në bazë të përmbajtjes dhe formës së shprehjes;
- Përdor ngjyra, vija dhe teksturë në punime grafike në funksion të idesë;
- Dallon stile dhe teknika të artistëve të ndryshëm sipas shkollave dhe periudhave artistike;
- Përdor teknika të ndryshme të vizualizimit (kolazh, fotografi, vizualizim, skica digjitale etj.) sipas mesazhit që duhet të përcjellë;
- Përdor funksione të avancuara në ndërtimin e vizatimeve dhe imazheve 3D sipas kërkesave të programit;
- Përdor programe kompjuterike për modelim teknik (AutoCAD, Revit, Rhino, SketchUp etj.) sipas tipologjisë së projektit;

- Përdor programe për vizualizim të imazheve (Blender, 3Ds Max, Lumion, V-Ray) sipas kërkesave të projekteve;
- Përdor softuerë për vizatime parametrike në dizajn modular (Grasshopper) sipas nevojës së projektit.

NjN-02-V-0208-25 Histori arti pamor dhe arkitekturë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë teknikat kryesore artistike në gjinitë e ndryshme të artit pamor si: pikturë, skulpturë, fotografi, instalacione, kolazhe, vizatim, dizenjim grafik, mënyra prezantimi;
2. Të përshkruajë stilet, rrymat dhe periudhat e ndryshme të historisë së artit pamor dhe arkitekturës;
3. Të përshkruajë zhvillimin historik të artit pamor dhe të arkitekturës sipas stileve të ndryshme të periudhave përkatëse (mesjetare, rilindase, baroke, gotike, klasike, rokoko, neoklasike, arti modern, bauhaus, post modern dhe atij bashkëkohor);
4. Të argumentojë lidhjen midis elementëve të artit pamor dhe dizenjimit të hapësirës në funksion të projektimit të ambienteve të brendshme;
5. Të japë shembuj të veprave dhe artistëve të ndryshëm të artit pamor dhe të arkitekturës në funksion të arredimit të ambienteve të brendshme;
6. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit të artit pamor nëpërmjet elementëve kryesor të tij, si: vijat, siluetat, pik-vijat, peizazhet me vija, format gjeometrike, format natyrore, format dinamike, ngjyrat, teksturaturat, vëllimet, hapësirat, harmoninë;
7. Të analizojë lidhjen dhe kombinimin e elementëve funksionalë dhe dekorativë në harmoni dhe në ritëm të artit pamor;
8. Të krahasojë rrymat artistike dhe stilistike që kanë ndikuar në dizenjimin e ambienteve të brendshme (p.sh. Art Deco, Bauhaus, Minimalizëm, Post modernizëm etj.);
9. Të përshkruajë ndikimin kulturor, fetar dhe social në zhvillimin e artit pamor dhe në arkitekturë;
10. Të listojë artistë dhe arkitektë të ndryshëm dhe veprat përfaqësuese të secilës periudhë dhe kontributin e tyre në zhvillimin e artit pamor;
11. Të përshkruajë zhvillimin historik të materialeve, teknikave dhe teknologjive artistike;
12. Të përshkruajë marrëdhënien midis funksionit, materialit dhe formës në arkitekturë.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë rregullat dhe normat e kompozimit (ekuilibri, kontrasti, ritmi, përsëritja, proporcioni) në dizenjimin e ambienteve të brendshme;
2. Të krijojë skica, kompozime, vizatime nëpërmjet teknikave të ndryshme të artit pamor;
3. Të dallojë stilet e ndryshme arkitektonikë dhe artistikë;
4. Të ndërthurë elementët historikë, artistikë dhe arkitekturorë në dekorimin e ambienteve të brendshme;
5. Të kombinojë materiale, ngjyra, elementë dekorativë sipas një periudhe historike dhe stili artistik- arkitekturorë të caktuar;
6. Të përzgjedhë vepra dhe dekoracione të artistëve dhe arkitektëve të ndryshëm;

7. Të përdorë terminologji të saktë profesionale artistike dhe arkitekturore;
8. Të përdorë kreativitet dhe origjinalitet në përzgjedhjen dhe kombinimin e elementëve arredues dhe dekorative të ambienteve të brendshme duke krijuar stilin e tij personal.

Kriteret e vlerësimit

- Përdor stile dhe rryma të ndryshme sipas periudhave përkatëse të historisë së artit pamor dhe arkitekturës;
- Zgjedh vepra të ndryshme të artistëve të artit pamor sipas funksionit dhe dekorimit në arredimit të ambienteve të brendshme;
- Zgjedh vepra të ndryshme të arkitektëve sipas funksionit dhe dekorimit në arredimit të ambienteve të brendshme;
- Përzgjedh elementë artistik sipas gjinive të ndryshme si: pikturë, skulpturë, fotografi, instalacione, kolazhe, vizatim, dizajn grafik etj.;
- Kontrollon dhe përzgjedh kombinimin e elementeve funksional dhe dekorativë sipas projekteve përkatëse;
- Përdor rryma artistike dhe stile në interior sipas dizajnit të caktuar në projektin përkatës (art nouveau, art deco, minimalizëm, post modernizëm etj.);
- Përdor materiale, ngjyra, elementë dekorativë sipas një periudhe, stili dhe rryme të caktuar në projektet përkatëse;
- Përdor terminologji të saktë profesionale artistike dhe arkitekturore sipas stilit dhe periudhës përkatëse.

NjN-02-V-0209-25 Dokumentacioni teknik në dizajnimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të dallojë tipologjitë e dokumentacioneve që nevojiten për fillimin, procesin dhe përfundimin e një projekti;
2. Të shpjegojë dokumentacionin përkatës sipas llojit të projektit dhe kuadrit ligjor;
3. Të shpjegojë mënyrën e hartimit të relacionit teknik, procesverbali ose një dokumenti më të përgjithshëm sipas nevojave të ndryshme;
4. Të kategorizojë dokumentacionet teknike duke përshkruar përdorimet e tyre;
5. Të shpjegojë llojet e dokumenteve administrative për fillimin e projektit (përmbledhje e kërkesave të klientit, të dhënat e zonës, formulimi i projektit në formën e detyrës së projektimit, kontrata marrëveshje, buxhetin e caktuar etj.);
6. Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të informacionit të kërkesës së klientit dhe dokumentimin e situatës faktike;
7. Të kategorizojë vizatime dhe dokumente grafike (projekte skematike, plane kati, fasada, prerje, detaje);
8. Të kategorizojë llojet e specifikimeve teknike;
9. Të listojë përbërjen e tabelave të zërave të materialeve, sasive dhe cilësive teknike në formate të standardizuara (dimensione, lista materialesh, folderat dyersh/dritaresh, pajisjesh,

mobilitet, listim etj.);

10. Të listojë llojet e raporteve dhe llogaritjeve (raporte strukturore, energjetike, teknike, ekologjike, element pejzazhi);
11. Të shpjegojë përmbajtjen e skedarëve për modelet digjitale *për projektet në përgjithësi dhe specifike* (p.sh. mobilitet), (skedarë BIM, 2D, CAD, 3D³ etj.);
12. Të listojë llojet e udhëzimeve/manualeve të operimit dhe mirëmbajtjeje të elementëve të projektit;
13. Të listojë llojet e dokumenteve për kolaudimin e projektit të realizuar;
14. Të shpjegojë mënyrat e dokumentimit të projektit final të zbatimit dhe shënimeve përgjatë operimeve për detaje të padukshme etj.;
15. Të listojë llojet e dokumenteve kontraktuale dhe ligjore (kontrata me klientët dhe nënkontraktorë, manuale për mënyrën e mirëmbajtjes, certifikatat e garancive, ofertime, procesverbale etj.) dhe përdorimet e tyre;
16. Të listojë llojet e dokumenteve të kontrollit dhe garantimit të cilësisë (ditare inspektimesh, certifikatë, shënime etj.);
17. Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me eprorët dhe kolegët për përpilimin, mbledhjen dhe arkivimin e dokumentacionit në formë fizike dhe digjitale.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të organizojë skedarët përkatës për një projekt të plotë në të gjitha fazat e tij;
2. Të ndihmojë në përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe raporteve të dokumentimit të projektit për fazat *fillim, proces dhe finalizim*;
3. Të grupojë dokumentacionin për kategoritë e administrimit të projektit (detyra projektimit, matjet faktike, dokumentimi i zonës dhe projektit, buxheti);
4. Të krijojë dosjet digjitale dhe fizike për dokumentimin e fazave të projektit;
5. Të asistojë për hartimin e udhëzuesve/manualeve të mirëmbajtjes, të kolaudimit dhe realizimit faktik etj.;
6. Të krijojë skedarët digjital ose fizik për listimin e materialeve, detajeve të përdorura, specifikimeve teknike etj.;
7. Të bashkëpunojë me eprorët dhe kolegët për përpilimin, mbledhjen dhe arkivimin e dokumentacionit në formë fizike dhe digjitale.

Kriteret e vlerësimit

- Grupon dokumentacionin për fillimin e projektit *sipas kategorive të ndara*;
- Përpunon informacionet fillestare nga kërkesat e klientit deri në detyrën e projektimit;
- Asiston/Përgatit dokumentet digjitale ose fizike të nevojshme sipas tipologjisë së projektit dhe detyrës së projektimit;
- Dokumenton informacionet e projektit sipas kategorive të ndryshme (matje faktike, dokumentim të objektit, buxheti, kërkesat specifike të klientit etj.);
- Harton relacionet teknike, procesverbale ose dokumente të përgjithshme sipas nevojave të ndryshme të projektit;

³ 3 dimensionale

- Asiston në hartimin e dokumentacionit tekniko-ligjore sipas standardeve tekniko-ligjore të projektit;
- Grupon tipologji të ndryshme raportesh sipas specialiteteve përkatëse (raporte strukturore, energjetike, teknike, ekologjike, element pejzazhi);
- Asiston në përgatitjen e dokumentacionit final (as-built) sipas projektit të realizuar faktik;
- Asiston në krijimin e dosjes së kolaudit sipas standardeve dhe projektit faktik;
- Menaxhon dokumentacionin për dosjet e modeleve digjitale *sipas fazave të ndryshme të projektit*;
- Bashkëpunon me kolegët për hartimin e grafikut të punimeve, sipas proceseve të punës;
- Raporton punën e kryer te eprorët sipas proceseve të punës dhe formateve të kërkuara.

NjN-02-V-0210-25 Baza e ndërtimit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të klasifikojë tipologjitë e ndryshme të ndërtesave (banim, administratë, arsim, shëndetësi, tregtare, turizëm, fetare) dhe hapësirave të brendshme si: zyra, banesa, administratë, komerciale, kulturore;
2. Të përshkruajë karakteristikat funksionale të ndërtesave dhe hapësirave të brendshme;
3. Të përshkruajë teknikat bazë të ndërtimit të ambienteve (zonimi, zgjedhja e materialeve, ndriçimi, mobilimi, dekorimi, instalimet teknike) dhe mënyrat e ndarjes;
4. Të shpjegojë strukturat mbajtëse dhe jo mbajtëse (kolona, tra, mur tulle, mur gipsi etj.);
5. Të listojë materialet konstruktive të përdorura në ndërtimin (beton, tullë, çelik, dru);
6. Të rendisë teknikat dhe materialet e përdorura në strukturë dhe në punime rifiniture;
7. Të listojë materialet e përdorura në ndërtimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme (bojëra, tekstile, pllaka, parket, pvc, vinile, veshje me dru);
8. Të përshkruajë tipologjitë e ndarjes së një hapësirë të brendshme me: beton, tullë, gips, xham, panele druri etj.;
9. Të përshkruajë veçoritë teknike, estetike dhe funksionale të materialeve që do të përdoren në projektimin e hapësirës së brendshme;
10. Të interpretojë planimetritë dhe specifikimet teknike të një ndërtimi për të kuptuar ndarjet e hapësirës dhe detajet në një ambient të brendshëm;
11. Të shpjegojë certifikatat e prodhimit dhe skedat teknike të materialeve të ndërtimit;
12. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të materialeve eficientë dhe ekologjike në ndërtim;
13. Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit të cilësisë së materialeve që do të përdoren sipas specifikimeve teknike në projekt.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të identifikojë tipet e ndryshme të ndërtesave dhe ndarjen e hapësirave të brendshme;
2. Të përzgjedhë materialet ndërtimore dhe dekorative bazuar në certifikatat e prodhimit, skedave teknike sipas përdorimit të tyre;
3. Të përdorë materiale eficientë dhe ekologjike;
4. Të kontrollojë normat dhe teknikat e ndërtimit, teknikat e izolimit, teknikat e shtrimit,

teknikat e instalimeve elektrike-hidraulike-hvac, ndarjet e brendshme për dekorimin e ambienteve të brendshme;

5. Të lexojë projektet teknike të ambienteve të brendshme;
6. Të realizojë matje në terren duke përdorur instrumente dhe mjete matëse.

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon tipet e ndryshme të ndërtesave sipas projekteve përkatëse;
- Identifikon funksionet e ambienteve sipas ndarjeve të hapësirave të brendshme;
- Përdor elementë të ndryshëm ndërtimor dhe dekorativ sipas kërkesave të dakordësuara;
- Përdor materiale me efikasitet energjitike, ekologjike dhe të qëndrueshme sipas specifikimeve në projektin përkatës;
- Zbërthen projektin arkitektonik sipas udhëzimeve të arkitektit/klientit në funksion të planifikimit;
- Zbërthen projektin konstruktiv sipas udhëzimeve të inxhinierit konstruktor në funksion të planifikimit;
- Zbërthen projektet elektrike, hidraulike, mekanike etj. sipas udhëzimeve të specialistëve përkatës në funksion të planifikimit;
- Kontrollon teknikat e ndërtimit sipas projekteve përkatëse në bashkëpunim me specialistët e fushës;
- Kontrollon teknikat e izolimit sipas projektit teknik dhe detajeve përkatëse në bashkëpunim me specialistin e fushës;
- Kontrollon teknikat e instalimeve elektrike, hidraulike, kondicionim, ventilim sipas projektit përkatës në bashkëpunim me specialistin e fushës;
- Kontrollon teknikat e shtrimit të ambienteve të brendshme sipas projektit përkatës në bashkëpunim me specialistin e fushës;
- Kontrollon realizimin e ndarjeve të brendshme sipas projektit përkatës në bashkëpunim me specialistin e fushës;
- Kontrollon realizimin e rifiniturave sipas projektit përkatës dhe specifikimeve teknike;
- Kontrollon cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe dekorimit të përzgjedhura sipas certifikatave të prodhimit dhe specifikimeve në projekt.

NjN-02-V-0211-25 Bazat e projektimit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë konceptet kryesore në bazat e projektimit (elementet e kompozimit, organizimi i hapësirës, elementët arkitektonikë);
2. Të shpjegojë konceptet e kompozimit (balancën, ritmin, kontrastet, pikat fokale dhe perspektivën, proporcionet dhe shkallën, harmoninë dhe unitetin);
3. Të shpjegojë elementet e kompozimit (linjat, format 2 dhe 3 dimensionale, teksturën, hapësirat negative (boshe), hapësirat pozitive (plot));
4. Të identifikojë tipologjitë e ndryshme të stileve të kompozimit;
5. Të përshkruajë teorinë e ngjyrave dhe impaktin e tyre në kompozim (ngjyra të ngrohta, të

ftohta);

6. Të përshkruajë karakteristikat ergonomike dhe antropometrike që sigurojnë funksionalitetin dhe komfortin në një hapësirë të caktuar;
7. Të listojë tipologjitë e funksioneve të hapësirës dhe funksionalitetin e tyre;
8. Të interpretojë sjelljet dhe ndërveprimet e njerëzve në raport me hapësirën dhe funksionin e saj;
9. Të diferencojë flukset e lëvizjeve në një hapësirë të caktuar;
10. Të përshkruajë tipologjitë e elementëve bazë të një objekti arkitektonik (muret, kolonat, trarët, dyshemetë, tavanet, çarjet, vetratat, dritaret, dyert);
11. Të dallojë elementët strukturalë nga elementët estetikë të një ambienti;
12. Të përshkruajë mënyrat e kompozimit të ndriçimit dhe ndikimin e tij në perceptimin e ngjyrave të ambienteve, materialeve dhe volumeve.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të hartojë një projekt bazuar në konceptet e kompozimit si; (balanca, ritmi, kontrastet, pikat fokale dhe perspektiva, proporcionet dhe shkalla e vizatimit, harmonia dhe uniteti, hapësira negative/boshe, hapësira pozitive/plote);
2. Të dallojë tipologjitë e ndryshme të stileve të kompozimit;
3. Të aplikojë teorinë e ngjyrave dhe impaktin e tyre në kompozim (ngjyra të ngrohta, të ftohta);
4. Të identifikojë karakteristikat ergonomike dhe antropometrike që sigurojnë funksionalitetin dhe komfortin në një hapësirë të caktuar;
5. Të zgjidhë funksionalitetin e hapësirave sipas tipologjisë së tyre;
6. Të analizojë ndërveprimet e njerëzve dhe flukset e lëvizjeve në raport me hapësirën dhe funksionin e saj;
7. Të identifikojë elementët bazë të një objekti arkitektonik (muret, kolonat, trarët, dyshemetë, tavanet, çarjet, vetratat, dritaret, dyert, elementet dekorativë);
8. Të përzgjedhë, për kompozim, tipologjitë e ndriçimit duke pasur parasysh ndikimin e tij në ngjyrat e ambienteve, në perceptimin e materialeve, në perceptimin e volumeve, në perceptimin e ngjyrave.

Kriteret e vlerësimit

- Zbërthen elementët e kompozimit sipas koncepteve bazë të tij; balanca, ritmi, kontrastet, pikat fokale dhe perspektiva, proporcionet dhe shkalla, harmonia dhe uniteti;
- Interpretin një kompozim arkitektonik sipas tipologjive të balancës (simetrike, asimetrike, radiale);
- Vizaton sipas rregullave të proporcioneve (lidhjen midis objekteve, p.sh.: mobilitet dhe dekorin);
- Vizaton pikat fokale sipas rregullave të perspektivës;
- Organizon ambiente në projekt sipas parimeve të hapësirave negative (boshe) dhe hapësirave pozitive (plote);
- Përzgjedh elementë dekorativë në projekt sipas tipologjive të ritmit, (përsëritës dhe i

përshkallëzuar progresivisht);

- Përzgjedh elementë dekorativë apo hapësinorë në projekt sipas ngjyrave (ngjyra të ngrohta, të ftohta);
- Përzgjedh motivet e ndryshme/teksturat sipas tipologjisë së tyre (p.sh.: tekstura në formë lineare, floreale, gjeometrike);
- Organizon një hapësirë sipas koncepteve të harmonisë dhe unitetit;
- Përzgjedh objekte sipas karakteristikave ergonomike dhe antropometrike;
- Organizon hapësirën sipas qëllimit të përdorimit primar;
- Organizon hapësirën sipas tipologjive të funksioneve të saj;
- Verifikon që hapësira e projektuar të jetë funksionale dhe konforte;
- Planifikon një hapësirë sipas flukseve të lëvizjeve;
- Kontrollon sjelljet dhe ndërveprimet e njerëzve sipas hapësirës dhe funksioneve të saj;
- Dallon elementët bazë të një objekti arkitektonik sipas tipologjisë së tyre (mure, kolona, trarë, dysHEME, tavane, çarje, vetrata, dritare, dyer, elementet dekorativë);
- Dallon elementët e një ambienti sipas funksionit estetik dhe struktural të tyre;
- Përdor tipologji të ndryshme ndriçimi sipas ndikimit që ato kanë në ngjyrat e ambienteve, në perceptimin e materialeve, në perceptimin e volumeve, në perceptimin e ngjyrave.

NjN-02-V-0212-25 Mobilimi i hapësirës

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të klasifikojë tipologjitë e materialeve (dru, metal, copa natyrale dhe industriale, plastika, mbushje etj.);
2. Të rendisë tipologjitë e aksesorëve të arredimit sipas funksionit;
3. Të shpjegojë ku integrohet sistemi i komandimit me internet në mobilie dhe pajisje të ndryshme (kuzhina, sistemi kondicionimit, komandimi i ndriçimit, komandimi i grilave dhe perdeve);
4. Të dallojë tipologjitë e menteshave, pistonave, strukturave mbajtëse të mobilie, dorezave, shinave etj.;
5. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të mobilie ergonomike;
6. Të përshkruajë teknikat artizanale dhe moderne të realizimit të mobilie;
7. Të rendisë tipologjitë e fabrikimeve digjitale (Makina prerëse të precesionit të lartë për prerje të drurit, metalit, materialeve kompozitë, printime 3 dimensionale për elementë dekorativë të mobilie);
8. Të përshkruajë teknikat e trajtimit të sipërfaqeve (ngjyrosje, lyerjet me shtresa mbrojtëse, diluentët, shtresat me rezinë për efekte dekorative etj.);
9. Të japë shembuj të aplikimit të teknikave për përdorim eficient të materialeve duke minimizuar shpërdorimin e tyre);
10. Të japë shembuj dizajni modular të mobilie;
11. Të listojë disa teknika të restaurimit të mobilie të vjetra (ripërdorim).

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të identifikojë tipologjitë e drurit;
2. Të dallojë tipologjitë e metaleve dhe përdorimit e tyre;
3. Të dallojë tipologjitë e copave natyrale, sintetike dhe përdorimi i tyre;
4. Të përzgjedhë tipologjitë e mbushjeve: shkumë (poliuretani, shkumë memorie), pupla ose opsione të qëndrueshme si lateksi ose fibra të ricikluara;
5. Të dallojë tipologjitë e xhamave dhe qeramikave (xham i thjeshtë, xham i temperuar, pllaka qeramike) dhe vetitë fizike të tyre;
6. Të dallojë tipologjitë e plastikës, kompozitëve dhe benefitet e tyre;
7. Të përzgjedhë tipologjitë e aksesorëve sipas funksionit;
8. Të përzgjedhë teknologjitë inteligjente ku integrohet sistemi i komandimit me internet në mobilie dhe pajisje të ndryshme (kuzhina, sistemi kondicionimit, komandimi i ndriçimit, komandimi i grilave dhe perdeve);
9. Të përcaktojë teknika të trajtimit të sipërfaqeve (ngjyrosje, lyerjet me shtresa mbrojtëse, diluentët, shtresat me rezinë për efekte dekorative etj.);
10. Të përdorë shembuj të aplikimit të dizajni modular dhe teknikave për përdorim eficient të materialeve.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh tipologjitë e trajtimit të rifiniturës së drurit sipas nevojave të përdorimit të tij (llaqe, vajra, solucione kundër insekteve);
- Përzgjedh metalet sipas tipologjisë së përdorimit të tyre (korniza strukturale, kolona metalike, elemente dekorativë);
- Përzgjedh tipologjinë e trajtimit të rifiniturës së metaleve sipas funksionit (veshje me pluhur, lustrim etj.);
- Dallon tipologjitë e copave sipas vetive fizike të tyre (fortësia, rezistenca ndaj njollave, tipologjia e teksturës, përshkueshmëria ndaj ajrit);
- Përzgjedh llojet e copave natyrale ose sintetike sipas përdorimit të tyre;
- Përzgjedh mbushjet sipas tipologjive të tyre: shkumë (poliuretani, shkumë memorie), pupla ose opsione të qëndrueshme si lateksi ose fibra të ricikluara;
- Përzgjedh tipologjitë e xhamave dhe qeramikave sipas funksionit të aplikimit të tyre xham i thjeshtë, xham i temperuar, pllaka qeramike;
- Përzgjedh tipologjitë e plastikës dhe kompozitëve sipas funksionit dhe përdorimit të tyre (akrilik, polikarbonatë, fibraxhami, fibra karboni);
- Përzgjedh aksesorë modernë të mobilieve sipas funksionit;
- Përzgjedh materialet e qëndrueshme sipas aplikimit në tipologji të ndryshme mobiliesh (bambu, tapa, dru i ricikluar, plastika të ricikluara, bioplastika etj.);
- Përzgjedh sisteme komandimi me internet në mobilie sipas nevojave dhe funksioneve të pajisjeve të ndryshme (kuzhina, sistemi kondicionimit, komandimi i ndriçimit, komandimi i grilave dhe perdeve);
- Përzgjedh mentesha, pistona, struktura mbajtëse të mobilieve, dorezave, shinave etj., sipas tipologjive të ndryshme;
- Përzgjedh mobilet sipas karakteristikave ergonomike;

- Përzgjedh mobilie artizanale ose moderne sipas teknikave të realizimit të tyre;
- Përzgjedh mënyrën e realizimit të mobilieve (me makina prerëse të precizionit të lartë për prerje të drurit, metalit, materialeve kompozitë);
- Përzgjedh mënyrën e realizimit të elementëve dekorativë të mobilieve sipas teknikave të printimeve 3 Dimensionale ose të prerjes me lazer;
- Përzgjedh teknika të trajtimit të sipërfaqeve të mobilieve sipas nevojës (ngjyrosje, lyster me shtresa mbrojtëse, diluentët, shtresat me rezinë për efekte dekorative etj.);
- Përcakton teknika eficiente të materialeve për të minimizuar shpërdorimin e tyre;
- Përzgjedh realizimin e mobilieve sipas shembujve të dizajnit modular;
- Bashkëpunon me mjeshtra për teknika artizanale (gdhendjet në dru dhe gur, rrahje të hekurit, vitrazhe, punime në baltë etj.);

NjN-02-V-0213-25 Projektim, Dizenjim, Dekorim

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë fazat e zhvillimit të një projekti arkitektonik të brendshëm;
2. Të theksojë rëndësinë e analizës së nevojave të përdoruesit përpara projektimit;
3. Të shpjegojë procesin e planifikimit të hapësirës në bazë të funksionalitetit;
4. Të përkufizojë termat bazë si: koncept, analizë, funksion, rrjedhë lëvizjeje;
5. Të shpjegojë rëndësinë e përshtatjes së mjedisit ku do të aplikohet projekti;
6. Të shpjegojë rëndësinë e standardeve teknike në projektim;
7. Të gjykojë përshtatshmërinë e materialeve dhe strukturës së përdorur;
8. Të listojë problemet potenciale në zbatimin e projektit;
9. Të theksojë rëndësinë e mbivendosjes së projekteve teknike (mobilitet, elektrike, ndriçim, ventilim, hidraulik etj.);
10. Të krahasojë zgjidhje të ndryshme hapësinore për të njëjtën nevojë;
11. Të shpjegojë rëndësinë e integritetit të sugjerimeve për përmirësim në projekt;
12. Të japë shembuj të projekteve të suksesshme si referencë;
13. Të përshkruajë stilin dhe identitetin e një veprë dizajni;
14. Të interpretojë kuptimin artistik në një dizajn vizual;
15. Të shpjegojë rëndësinë e përfshirjes së elementëve të trashëgimisë kulturore në dizajn bashkëkohor;
16. Të dallojë elementët estetikë nga ata teknikë në një dizajn;
17. Të vlerësojë qartësinë e komunikimit vizual në dizajn;
18. Të argumentojë zgjedhjet estetike në funksion të mesazhit;
19. Të këmbëjë ide në një proces bashkëpunues dizajni;
20. Të japë shembuj të dizajnit efektiv nga praktika ndërkombëtare;
21. Të japë konkluzione mbi ndikimin e dizajnit në sjellje dhe përvojë;
22. Të përshkruajë stilin dekorativ të një ambienti;
23. Të listojë elementët dekorativë: perde, mobilie, tekstile, aksesorë;
24. Të shpjegojë ndikimin e detajeve dekorative në përjetimin hapësinor;
25. Të shpjegojë stilet dekorative (rustik, modern, klasik);

26. Të parashikojë elementë sezonalë ose tematikë për dekorim;
27. Të shpjegojë përdorimin e instalacioneve për dekorimin e ambienteve;
28. Të shpjegojë tipologjitë e gjelbërimit si elementë dekorativë;
29. Të diskutojë për përzgjedhjen e materialeve dhe elementëve zbukurues;
30. Të nënvizojë rëndësinë e detajeve të vogla në dekor;
31. Të përmbledhë konceptin në një poster, booklet apo prezantim.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të analizojë kërkesat dhe nevojat e klientit për të ndërtuar një projekt të strukturuar dhe të përshtatshëm me kontekstin dhe funksionin e hapësirës;
2. Të hartojë hapat e projektimit, duke përfshirë konceptimin, planifikimin funksional, vizatimet teknike dhe përgatitjen e prezantimeve vizuale;
3. Të aplikojë standardet teknike, duke përfshirë përputhshmërinë me projektet elektrike, ndriçimin, ventilimin, mobilimin dhe sistemet hidraulike;
4. Të përdorë elementë estetikë dhe teknikë për të krijuar një dizajn të qartë dhe funksional që përçon mesazhe përmes komunikimit vizual;
5. Të përfshijë elementë të trashëgimisë kulturore, stile dekorative, gjelbërim dhe detaje të vogla për të rritur përjetimin hapësinor dhe identitetin e dizajnit;
6. Të modifikojë projektin bazuar në sugjerime, duke integruar shembuj të suksesshëm nga praktika vendase dhe ndërkombëtare;
7. Të përmbledhë projektin në formën e një posteri, broshura ose prezantimi profesional.

Kriteret e vlerësimit

- Analizon nevojat funksionale të klientit duke shqyrtuar informacionin e ofruar;
- Vlerëson ndikimin e mjedisit fizik në vendosjen dhe organizimin e hapësirës;
- Projekton forma ose stile të ndryshme bazuar në modelet referuese;
- Identifikon kufizimet dhe potencialet e hapësirës për projektin bazuar në kërkesat e klientit;
- Rishikon draftet për përmirësimin e cilësisë sipas kërkesave të projektit;
- Harton projektin e dizajnimit dhe dekorimit të ambientit të brendshëm sipas fazave dhe metodologjive përkatëse;
- Vizaton plane, seksione dhe pamje sipas zgjidhjeve hapësinore;
- Projekton sipas standardeve teknike për ndriçim, ventilim, mobilim dhe sisteme të tjera ndihmëse dhe udhëzimeve të specialistëve përkatës;
- Kontrollon mbivendosjen e vizatimeve teknike (mobilim, ndriçim, ventilim, hidraulik) sipas integritetit funksional;
- Përzgjedh elementët dekorativë bazuar në harmoninë estetike duke përdorur aksesore sipas kërkesave të projektit dhe parimeve të kompozicionit;
- Përdor instalacionet për dekorimin e ambienteve në bazë të efekteve vizuale;
- Përfshin elementë të trashëgimisë kulturore në dizajnin bashkëkohor sipas kontekstit lokal;
- Përdor stilet dekorative (rustik, modern, klasik) në përputhje me kërkesat e projektit;
- Përmirëson projektin në procesin e zhvillimit sipas sugjerimeve;
- Përdor shembuj nga projekte të suksesshme si referencë për ide të reja;

- Përdor elementë arkitekture për të rritur cilësinë vizuale;
- Përdor komunikimit vizual në dizajn sipas parimeve të grafikës vizuale;
- Shkëmben ide në një proces bashkëpunues dizajni për të përmirësuar rezultatin;
- Përzgjedh tipologji të gjelbërimit si element dekorativ në raport me ambientin;
- Përgatit postera, broshura apo prezantime sipas mënyrave efektive të paraqitjes.

NjN-02-V-0214-25 Hartimi i projekt – zbatimit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë programin, qëllimin e projektit në zhvillim, bazuar në të dhënat dhe dokumentet faktike të mbledhura;
2. Të shpjegojë konkluzionet e mbledhura të analizave logjike dhe artistike të reflektuara në një koncept dizajn përfundimtar;
3. Të përshkruajë mënyrat e hartimit të projektit-zbatimit, nëpërmjet vizatimeve, skicimeve fizike dhe digjitale maketeve ose virtuale;
4. Të përshkruajë llojet e materialeve dhe arsyt ose referencat e përzgjedhura në lidhje me projektin në zhvillim;
5. Të përshkruajë specifikimet teknike në formë sasiore dhe cilësore për projektin në zbatim dhe materialet e përzgjedhura;
6. Të përshkruajë standardet e ndriçimit të përdorura (natyral-artificial) në tipologji të ndryshme projektesh (banim, tregtar etj.);
7. Të shpjegojë llojet e ndryshme të dyshemeve dhe detajet teknike të tyre sipas standardeve përkatëse për format projekt-zbatimi;
8. Të shpjegojë normat e projektimit të planeve teknike për ndarjen e hapësirave të dimensionuar, sipas standardeve përkatëse për format projekt-zbatimi;
9. Të përshkruajë normat për projektimin e detajeve të ndarjes së hapësirave (muraturë, gips etj. për zhvillimin e hapësirës, të dimensionuar, sipas standardeve përkatëse për format projekt-zbatimi;
10. Të shpjegojë normat e pozicionimit të daljeve elektrike, hidraulike dhe ventilim-kondicionimit sipas standardeve përkatëse për format projekt-zbatimi;
11. Të përshkruajë llojet e pajisjeve të ventilim-kondicionimit;
12. Të përshkruajë normat dhe parimet e qarkullimit të ajrit dhe ventilimit mekanik dhe natyral për komfort termik optimal;
13. Të përshkruajë llojet e elementëve të dukshëm të instalimeve elektrike karakteristikat dhe përdorimet e tyre;
14. Të rendisë elementet dekorative të përdorur duke i dokumentuar në dosjet përkatëse;
15. Të përshkruajë planin e dyer-dritareve dhe veshjeve të xhamit, sipas standardeve përkatëse për format projekt-zbatimi;
16. Të shpjegojë mënyrën e përmbledhjes në tabelën e sipërfaqeve dhe të volumeve të materialeve të përdorura, sipas projektit final për të zhvilluar preventivimin;
17. Të përshkruajë formatin dhe elementët e grafikut të punimeve.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të hartojë planin e organizmit të hapësirës sipas qëllimit të detyrës së projektimit dhe normave bazë të projektimit;
2. Të krijojë vizatime në formatin 2 dimensional dhe 3 dimensional në programe softuere për qëllimin final të zbatimit të projektit;
3. Të krijojë vizatime për planin teknik të dimensionuar në format projekt-zbatimi;
4. Të krijojë vizatime për planin mobilim të detajuar në format projekt-prodhimi;
5. Të krijojë plane teknike të dimensionura për zbatimin e instalimeve të ndryshme si p.sh.: elektrike, hidraulike dhe ventilim mekanik në format projekt-zbatimi;
6. Të dokumentojë specifikimet teknike të materialeve, teksturave me anë të imazheve, dimensioneve, emërtimeve apo kodeve përkatëse;
7. Të përgatitë dokumentin final të tabelës së sipërfaqeve dhe volumeve;
8. Të hartojë listën e materialeve ose dekoreve/instalacioneve, si dhe planin e pozicionimit të tyre;
9. Të bashkëpunojë në hartimin e grafikut të punimeve dhe në koordinimin me ekspertët përkatës;
10. Të reflektojë ndryshimet sipas kërkesave të reja dhe nevojave të projektit në proces;
11. Të përgatitë prezantimin final të dokumentit teknik dhe të zbatimit të projektit.

Kriteret e vlerësimit

- Planifikon organizimin e hapësirës sipas të dhënave dhe kërkesave të klientit;
- Krijon planin funksional final të organizimit të hapësirës sipas detyrës së projektimit;
- Përdor mjete dhe teknika të ndryshme në projekt zbatimit, p.sh. skicat, maketet, programet virtuale etj. sipas nevojës për të vizualizuar qartë detaje;
- Përdor programe kompjuterike të ndryshme për vizatime në formatin 2D dhe 3D sipas nevojës për të vizualizuar qartë zbatimin e projektit;
- Përdor prerje teknike të tipologjive të ndryshme për ndarje të hapësirave (muraturë, gips, xham, panele etj.) sipas standardeve përkatëse për format projekt-zbatimi;
- Vizaton planin teknik me dimensione dhe shënimet përkatëse sipas formatit projekt-zbatimi;
- Vizaton planin e mobilimit të detajuar sipas formatit projekt-prodhimi;
- Harton planet teknike me dimensione dhe shënimet përkatëse për zbatimin e instalimeve të ndryshme si p.sh. elektrike, hidraulike dhe ventilim mekanik sipas formatit të projekt-zbatimit;
- Reflekton ndryshimet në projektin në proces sipas kërkesave të reja nga klienti dhe situatat në terren;
- Harton listën e elementëve të dukshëm të instalimeve elektrike me karakteristikat dhe përdorimet e tyre sipas planit të projekt zbatimit të instalimeve elektrike;
- Harton tabelën e dyer-dritareve, xhamave dhe pasqyrave sipas standardeve përkatëse për format projekt-zbatimi;
- Dokumenton specifikimet teknike të materialeve, teksturave me anë të imazheve, dimensioneve, emërtimeve apo kodeve përkatëse sipas formatit projekt-prodhimi;
- Përgatitë dokumentin final të tabelës së sipërfaqeve dhe volumeve sipas llogaritjeve finale;

- Harton listën e materialeve, dekoreve/instalacioneve, si dhe planin e pozicionimit të tyre, sipas formatit projekt-prodhimi;
- Bashkëpunon për hartimin e grafikut të punimeve dhe koordinimin me ekspertët përkatës sipas planit të organizimit të punimeve;
- Përgatit prezantimin final të dokumentit teknik të projektit të zbatimit sipas standardeve përkatëse të faqesjes dhe formatimit.

NjN-02-V-0215-25 Realizimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të projektit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së furnitorit sipas zërave të punimeve;
2. Të përshkruajë radhën e punës për zbatimin e projektit;
3. Të argumentojë rëndësinë e kontrollit të afateve të punimeve;
4. Të përshkruajë hapat e punës për mobilimin, rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit të këtij procesi;
5. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e kontrollit të shtrimit të dyshemeve dhe veshjeve të murit;
6. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e kontrollit të realizimit të tavaneve;
7. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e kontrollit të realizimit të ndriçimit;
8. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e kontrollit të pozicionimit të pajisjeve të ajrim-ventilimit;
9. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e kontrollit të vendosjes së xhamave;
10. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e kontrollit të vendosjes së dyerve dhe dritareve;
11. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e kontrollit të vendosjes së materialeve metalike;
12. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e kontrollit të vendosjes së elementëve dekorative;
13. Të shpjegojë rëndësinë e krahasimit të specifikimeve teknike të materialeve dhe teksturave në përputhje me projektin;
14. Të listojë llojet e dokumenteve dhe certifikatave të produkteve të përfshira në projekt;
15. Të listojë mënyrat e mbikëqyrjes së proceseve të ndryshme të zbatimit;
16. Të argumentojë normat e pozicionimit të daljeve elektrike dhe atyre hidraulike;
17. Të identifikojë llojet e elementëve të dukshëm të instalimeve hidraulike, elektrike, karakteristikat dhe përdorimet e tyre;
18. Të përshkruajë parimet e qarkullimit të ajrit për të arritur konfortin termik;
19. Të listojë llojet e pajisjeve të ajrim-ventilimit;
20. Të klasifikojë llojet ose strukturat përbërëse të xhamit (xham i zakonshëm, i temperuar, i laminuar, me ngjyra, reflektues, i tejdukshëm, dekorativ etj.);
21. Të listojë llojet kryesore të mekanizmave të vetratave, dritareve dhe dyerve;
22. Të përshkruajë tipologjitë e dyerve dhe dritareve, karakteristikat dhe përdorimet e tyre;
23. Të shpjegojë rëndësinë e detajeve të mobilimit dhe realizimit të tyre;
24. Të shpjegojë rëndësinë e specifikimeve teknike të materialeve dhe teksturave sipas projektit;
25. Të shpjegojë rëndësinë e certifikatave të produkteve të përdorura në projekt.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë nënkontraktorët përkatës për zbatimin e projektit;
2. Të koordinojë radhën e punës për afatet e punimeve;
3. Të bashkëpunojë me profesionistë të tjerë të ndërtimit (murator, elektrikist, hidraulik, mobilier etj.);
4. Të kontrollojë proceset për zbatimin e projekteve të ndryshme teknike (projekti i mobilimit, ndarjes funksionale, shtrimit, tavanit, elektrik, hidraulik, ajrim-ventilim, xhamave, dyerve, dritareve, punimeve metalike);
5. Të kontrollojë proceset e punës për zbatimin e projektit të elementëve dekorativë, artistikë dhe elementëve të gjelbërimit;
6. Të kontrollojë përputhshmërinë e materialeve dhe teksturave të përcaktuara në projekt;
7. Të koordinojë dhe përditësojë grafikun e punimeve për zbatimin e projektit;
8. Të kontrollojë tabelën e sasive, sipërfaqeve dhe volumeve sipas zërave në projekt;
9. Të kontrollojë dokumentet e certifikimit të produkteve dhe materialeve të ndryshme të përcaktuara në projekt;
10. Të kontrollojë detajet dhe specifikimet teknike të materialeve dhe teksturave të ndryshme në projekt;
11. Të hartojë dokumentin final të dorëzimit të punimeve.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh nënkontraktorët përkatës sipas zërave të projekt-zbatimit;
- Zbaton afatet dhe hierarkinë e punimeve sipas grafikut të punimeve;
- Bashkëpunon me profesionistë të tjerë sipas projekteve teknike përkatëse;
- Kontrollon procesin e zbatimit të mobilimit sipas projektit përkatës në bashkëpunim me specialistin e fushës;
- Mbikëqyr procesin e punës për zbatimin e projektit të ndarjeve të hapësirave në bashkëpunim me specialistët përkatës sipas projekt-zbatimit;
- Mbikëqyr procesin e punës për zbatimin e projektit të shtrimit të dysHEMEVE në bashkëpunim me specialistët përkatës sipas projekt-zbatimit;
- Mbikëqyr procesin e punës për zbatimin e projektit të tavaneve në bashkëpunim me specialistët përkatës sipas projekt-zbatimit;
- Mbikëqyr procesin e punës për zbatimin e projektit të ndriçimit në bashkëpunim me specialistët përkatës sipas projekt-zbatimit;
- Mbikëqyr procesin e punës për zbatimin e projektit elektrik në bashkëpunim me specialistët përkatës sipas projekt zbatimit;
- Mbikëqyr procesin e punës për zbatimin e projektit hidraulik në bashkëpunim me specialistët përkatës sipas projekt-zbatimit;
- Mbikëqyr procesin e punës për zbatimin e projektit të ajrim-ventilimit, në bashkëpunim me specialistët përkatës sipas projekt-zbatimit;
- Mbikëqyr procesin e punës për zbatimin e projektit të sipërfaqeve me xhama dhe pasqyra në objekt, në bashkëpunim me specialistët përkatës sipas projekt-zbatimit;
- Mbikëqyr procesin e punës për zbatimin e projektit të dyerve në objekt, në bashkëpunim me

specialistët përkatës sipas projekt-zbatimit;

- Mbikëqyr procesin e punës për zbatimin e projektit të dritareve dhe vetratave në objekt, në bashkëpunim me specialistët përkatës sipas projekt-zbatimit;
- Mbikëqyr procesin e punës për zbatimin e projektit të punimeve metalike, në bashkëpunim me specialistët përkatës sipas projekt-zbatimit;
- Mbikëqyr procesin e punës për zbatimin e projektit me materiale të tjera në objekt, në bashkëpunim me specialistët përkatës sipas projekt-zbatimit;
- Mbikëqyr procesin e punës për zbatimin e projektit të elementëve dekorativë dhe artistike, në bashkëpunim me specialistët përkatës sipas kërkesave të projekt-zbatimit;
- Kontrollon përputhshmërinë e materialeve dhe teksturave sipas specifikimeve teknike të projektit;
- Përditëson grafikun e punimeve për zbatimin e projektit sipas ecurisë së punimeve;
- Kontrollon sasinë e duhura të elementëve të projektit sipas tabelës së volumeve dhe sipërfaqeve;
- Kontrollon certifikatat e materialeve dhe produkteve sipas specifikimeve në projekt;
- Harton dokumentin final të dorëzimit të punimeve sipas formateve të paracaktuara;
- Monitoron garancinë e punimeve sipas akt-marrëveshjes.

NjN-23-V-0111-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve;
2. Të shpjegojë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to;
3. Të përshkruajë rëndësinë e një qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme;
4. Të analizojë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore;
5. Të listojë përgjegjësit individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore;
6. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit me efikasitet të burimeve të ndryshme si: mjedisin, materialet, paratë, kohën etj.;
7. Të përshkruajë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme;
8. Të shpjegojë mënyrën e menaxhimit të burimeve materiale, njerëzore dhe financiare për zhvillimin e biznesit;
9. Të përshkruajë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit digjital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes;
10. Të përshkruajë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale;
11. Të përshkruajë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre;
12. Të analizojë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.;
13. Të përmbledhë parimet bazë të legjislacionit financiar dhe kodit të punës;
14. Të përshkruajë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje;

15. Të përshkruajë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës;
16. Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit;
17. Të përshkruajë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi;
18. Të përshkruajë procedurat e regjistrimit dhe fazat e zhvillimit të biznesit;
19. Të shpjegojë mënyrën e llogaritjeve ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi;
20. Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së kostove dhe çmimeve të produkteve e shërbimeve të një biznesi;
21. Të japë shembuj të mënyrës së përgatitjes së një oferte për shërbimin që do të kryejë;
22. Të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes;
23. Të përshkruajë veprimet individuale me institucionet financiare, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet;
24. Të listojë teknika të vetëvlerësimit në aspektin profesional;
25. Të përshkruajë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës (trajnime, kurse, panaire, ekspozita etj.).

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën, lidhur me aktivitetin që kryen;
2. Të regjistrojë të dhënat e faturave dhe përgatitjes së një oferte;
3. Të kontrollojë çmimet e tregut të materialeve bazuar në standardet e ndërtimit;
4. Të llogarisë koston e materialeve dhe çmimin e një shërbimi;
5. Të kryejë blerje të materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme;
6. Të llogarisë çmimin përfundimtar për punimet/shërbimet e ofruara;
7. Të demonstrojë aftësi sipërmarrëse për të zhvilluar një projekt-ide, për të zhvilluar dhe zbatuar një buxhet të caktuar);
8. Të transmetojë në kohë tek bashkëpunëtorët njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
9. Të përdorë literaturën bashkëkohore;
10. Të marrë pjesë në panaire dhe ekspozita, trajnime dhe kurse teknike;
11. Të zbatojë teknikat e marketingut.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin e lidhur me aktivitetin;
- Harton një plan të thjeshtë biznesi, sipas metodologjisë përkatëse;
- Zbaton kushtet paraprake dhe procedurat për fillimin e një biznesi në fushën e projektimit, sipas legjislacionit në fuqi;
- Zbaton teknikat e duhura të marketingut;
- Merr periodikisht informacion nga tregu për çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve;

- Përgatit oferta për produktet/shërbimet që do të ofrojnë sipas llojit të shërbimit;
- Kryen llogaritje të sakta të kostos të një shërbimi të kryer sipas detyrës së dhënë;
- Llogarit çmimin përfundimtar për shërbimet e ofruara referuar çmimeve të tregut;
- Plotëson lloje të ndryshme të faturave, sipas produktit/shërbimit që do të ofrojnë;
- Respekton afatet e përcaktuara për realizimin e veprimtarive të veta;
- Vlerëson veten lidhur me nevojat për kualifikimit referuar proceseve të punës;
- Ndjek trajnimet për ngritje profesionale dhe teknika të reja në punë, sipas teknologjisë bashkëkohore;
- Transmeton njohuritë dhe teknikat e reja në punë tek bashkëpunëtorët sipas procesit të punës;
- Merr pjesë rregullisht në panaire dhe ekspozita në fushën e ndërtimit dhe dizenjmit;
- Bashkëpunon me institucione financiare, sipas legjislacionit dhe nevojës.

NjN-22-V-0130-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal sipas kodit të etikës;
2. Të shpjegojë rëndësinë e njohjes së kodit të etikës;
3. Të shpjegojë rëndësinë e rregullave të mirësjelljes në bashkëbisedim;
4. Të shpjegojë rëndësinë e informimit të vazhdueshëm mbi problemet dhe të rejat e ditës;
5. Të përkufizojë terminologjinë e nevojshme profesionale gjatë kryerjes së punës;
6. Të shpjegojë rëndësinë e teknologjive bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit;
7. Të shpjegojë rëndësinë e njohjes së rregullores së brendshme të organizatës;
8. Të përshkruajë rregullat e komunikimit sipas hierarkisë profesionale;
9. Të vlerësojë rëndësinë e bashkëpunëtorëve dhe roli i tyre në veprimtarinë profesionale;
10. Të përshkruajë metodat e zgjidhjes së ankesave dhe mosmarrëveshjeve me klientët;
11. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknikave të motivimit;
12. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së konfidencialitetit dhe të dhënave sipas politikave të organizatës;
13. Të shpjegojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim;
14. Të shpjegojë rëndësinë e identifikimit të nevojave të klientit, duke i grupuar sipas stilit të jetesës, preferencave dhe kërkesave funksionale.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë teknikat e komunikimit;
2. Të zbatojë kodin e etikës në komunikimin me të tjerët;
3. Të përdorë terminologji profesionale gjatë komunikimit;
4. Të punojë në grup;
5. Të zbatojë rregullat e komunikimit në gjuhë të huaj;
6. Të respektojë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;

Kriteret e vlerësimit

- Merr vazhdimisht informacione për detyrat dhe të rejat e ditës;
- Zbaton parimet e punës në grup në mënyrë korrekte;
- Bashkëpunon rregullisht me eprorët dhe kolegët;
- Zbaton drejtë dhe saktë rregullat e mirësjelljes në komunikimin verbal dhe jo verbal;
- Zbaton me korrektësi parimet e etikës profesionale;
- Zgjidh ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët, duke zbatuar teknikat përkatëse;
- Përdor rregullisht teknologjitë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit me të tjerët;
- Përdor saktë terminologjinë teknike dhe profesionale, sipas rregullave të komunikimit;
- Mbron të dhënat e organizatës duke zbatuar politikat dhe legjislacionin përkatës;
- Respekton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
- Dëgjon me vëmendje për të qenë aktiv në një komunikim;
- Respekton në mënyrë korrekte nivelet hierarkike në organizatë sipas kodit të etikës;
- Bashkëpunon në veprimtarinë profesionale, sipas parimeve të punës në grup.

NjN-02-V-0216-25 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë Standardet dhe legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
2. Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik për veten dhe ekipin në punimet në lartësi;
3. Të shpjegojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës në ambientet elektrike me tension, duke përfshirë izolimin e rrymës dhe identifikimin e rreziqeve të ndezjes;
4. Të shpjegojë domosdoshmërinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
5. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të pajisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive në punë;
6. Të përshkruajë llojet e mjeteve të ndihmës së parë dhe përdorimi i tyre;
7. Të përshkruajë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
8. Të shpjegojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
9. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri, kontaktit me energjinë elektrike dhe shpëtimi;
10. Të përshkruajë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
11. Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
12. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregulloreve përkatëse për depozitimin e mbetjeve;
13. Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
14. Të përshkruajë protokollet e duhura në raste të gjendjeve të jashtëzakonshme.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës;
2. Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;
3. Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton standardet dhe legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- Zbaton rregullat e sigurimit teknik për veten dhe ekipin në punimet në lartësi;
- Zbaton rregullat e sigurimit teknik gjatë punës në ambientet elektrike me tension dhe rrezik zjarri;
- Përdor pajisje mbrojtëse individuale dhe kolektive në punë sipas rregullave dhe proceseve të punës;
- Përdor mjetet dhe pajisjet e punës sipas manualeve përkatëse;
- Përdor pajisjet e mbrojtjes nga zjarri, kontaktit me energjinë elektrike dhe shpëtimit sipas rregullores;
- Jep ndihmën e parë në rast aksidenti, goditje nga rryma elektrike, sipas rregullave përkatëse;
- Përdor mjetet e dhënies së ndihmës së parë me korrektësi;
- Zbaton procedurat e evakuimit për raste emergjence sipas protokolleve;
- Zbaton rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- Zbaton rregulloret përkatëse për depozitimin e mbetjeve në përputhje me rregulloret e mjedisit;
- Zbaton rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit sipas legjislacionit;
- Zbaton rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm;
- Zbaton protokollet e duhura në raste të gjendjeve të jashtëzakonshme.

Njësitë e të nxënit dhe peshat përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punës në dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme	3	NjN-02-V-0206-25
2	Vizatimi (teknik, i lirë, digjital etj.)	12	NjN-02-V-0207-25
3	Histori arti pamor dhe arkitekturë	5	NjN-02-V-0208-25
4	Dokumentacioni teknik në dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme	9	NjN-02-V-0209-25
5	Baza e ndërtimit	9	NjN-02-V-0210-25
6	Bazat e projektimit	9	NjN-02-V-0211-25
7	Mobilimi i hapësirës	7	NjN-02-V-0212-25
8	Projektim, Dizënjim, Dekorim	15	NjN-02-V-0213-25
9	Hartimi i projekt-zbatimit	10	NjN-02-V-0214-25
10	Realizimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të projektit	12	NjN-02-V-0215-25
11	Sipërmarrje dhe edukim karriere	3	NjN-23-V-0111-24
12	Komunikimi dhe etika profesionale	3	NjN-22-V-0130-24
13	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme	3	NjN-02-V-0216-25

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mbledhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: B1-V-25

B – Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

1 – Numri që identifikon profilin/specializimin e kualifikimit përkatës

V – Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: NjN-02-V-0206-25

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

02 – Numri që identifikon fushën e Njësisë së të Nxënit

V – Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0206 – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit

